



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 15 shkurt 2024  
Nr. Ref.: AGJ 2366/24

## AKTGJYKIM

në

**rastin nr. KI137/23**

Parashtrues

**Naim Berisha**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. nr. 451/2022 të 23 nëntorit  
2022 të Gjykatës Supreme**

## GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhami Rexhepi, gjyqtar dhe  
Enver Peci, gjyqtar

### Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është dorëzuar nga Naim Berisha, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

## Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev.nr. 451/2022] të 23 nëntorit 2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), në ndërlidhje me Aktgjykimin [Ac.nr. 3544/15] të 15 nëntorit 2019 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [C. nr. 2906/12] të 28 prillit 2015 të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).
3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 22 shkurt 2023.

## Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, [Rev.nr. 451/2022] të Gjykatës Supreme, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur nenet 22 [Zbatimi i drejtëpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNj).

## Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridikzioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) dhe 44 (Kërkesa për masë të përkohshme) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).
6. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 01/2023 u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur, e cila ka shfuqizuar Rregulloren e punës nr. 01/2018. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës nr. 01/2018 do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruar në Gjykatë, para shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

## Procedura në Gjykatë

7. Më 21 qershor 2023, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
8. Më 26 qershor 2023, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Më 27 qershor 2023, Kryetarja e Gjykatës, me vendimin GJR. KI137/23, caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe me vendimin KSH. KI137/23 emëroi

anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).

10. Më 14 shtator 2023, Gjkata kërkoi nga Gjkata Themelore që të dorëzojë fletëkthesën, si dëshmi e dorëzimit të Aktgjykimit të kontestuar te parashtruesi i kërkesës.
11. Më 15 shtator 2023, Gjkata Themelore dorëzoi dokumentin e lartpërmendur, me të cilin u vërtetua se parashtruesit të kërkesës iu dorëzua Aktgjykimi i kontestuar më 22 shkurt 2023.
12. Më 18 janar 2024, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit rapportues dhe me shumicë votash i rekomandoi Gjykatës që ta deklarojë kërkesën të pranueshme dhe të konstatojë shkelje të të drejtave të garantuara me paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së.

### Përbledhja e faktave

13. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës ka qenë i angazhuar si aktor në Teatrin Kombëtar të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: TKK). Nga viti 2009, deri në vitin 2014, parashtruesi i kërkesës ishte i angazhuar me kontratë mbi vepër në TKK. Në vitin 2015 parashtruesi i kërkesës lidhi kontratë të rregullt në kohë të caktuar me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: MKRS).
14. Më 23 qershor 2011, Qeveria e Kosovës nxori Rregulloren nr. 05/2011, me qëllim të përcaktimit të sistemit të gradimit dhe të pagave të krijuesve dhe performuesve të kulturës dhe të punonjësve profesionistë të trashëgimisë kulturore, që janë nën varësi të MKRS-së.
15. Më 3 korrik 2012, TKK-ja nëpërmjet shkresës nr. 245 ia dërgoi MKRS-së listën e nëntë (9) punëtorëve, që kishin arritur tre (3) vite pune të pandërprerë, me kërkesë që të njëjtit të përfshiheshin në kontratën e rregullt të punës, në përputhje me Rregulloren përkatëse. Në mesin e këtyre punëtorëve ishte edhe parashtruesi i kërkesës.
16. Më 12 tetor 2012, me anë të shkresës nr. 308, TKK i kërkoi MKRS-së që parashtruesit të kërkesës t'i ngritët koeficienti nga pesë (5) në gjashtë (6).
17. Më 9 nëntor 2012, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Themelore, me kërkesë që të obligohet e paditura MKRS, të lidhë kontratë të rregullt të punës, duke pretenduar se i plotëson kriteret ligjore për të kaluar nga kontrata mbi vepër në kontratë të rregullt, dhe t'ia kompensojë dëmin material, si pasojë e diskriminimit në koeficient dhe pagë, në raport me kolegët e tij aktorë. Parashtruesi i kërkesës argumentoi se në bazë të Ligjit të punës dhe Rregullores nr. 05/2011, ai ka fituar të drejtën për të lidhur kontratë të rregullt, ngase më 1 korrik 2012 i ka mbushur tre (3) vjet përvjetorë pune, duke pretenduar se ky kriter ishte zbatuar për kolegët e tij, theksoi se moszbatimi i të njëjtit për të do të paraqiste diskriminim. Në fund, parashtruesi e kërkoi kompensimin për dëmin e shkaktuar, në vlerë të përgjithshme prej gjithsej 12,201.00 euro.
18. Më 28 prill 2015, Gjkata Themelore, me Aktgjykimin [C. nr. 2906/12] e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Për sa i përket çështjes së mos-legalizimit të vendit të punës kjo gjykatë, theksoi: “*Sipas nenit 19 të Rregullores nr.05/2011, veç tjerash përcaktohet që vendet e punës në institucionet e kulturës dhe trashëgimisë kulturore legalizohen me automatizëm [...] kriteret për legalizim janë: dëshmia për marrëdhënien e punës me kontratë mbi vepër pa shkëputje në tre vitet e*

*fundit [...]. Pas vlerësimit të kritereve të përcaktuara në Rregulloren sa i përket legalizimit të vendeve të punës, gjykata ka gjetur se në kohën e miratimit të Rregullores, paditësi nuk e ka plotësuar kriterin - marrëdhënie e punës me kontratë mbi vepër pa shkëputje në tre vitet e fundit, pasi nga vetë deklarimi i paditësit ka rezultuar se ai në atë kohë kishte kontratë për vepër, dy vite pa ndërprerë. Prandaj, duke marrë për bazë kohën e parashtrimit të padisë dhe duke vendosur brenda kufijve të kërkesëpadisë, gjykata gjeti se kërkesëpadia për legalizimin e vendit të punës dhe kompensimin e diferencës së pagës është e pabazuar, pasi paditësi nuk ka plotësuar kushtin nga neni 19”.*

19. Përkitazi me pretendimin për diskriminim, Gjykata Themelore, theksoi: “*Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e paditësit për trajtim diskriminues në raport me kolegët tjerë aktorë, e në veçanti me aktorin Sh. K., e që ky i fundit sipas pohimeve, duke qenë në situatë të njëjtë me paditësin pra, edhe pse kishte dy vite kontratë të pandërprerë për vepër, me të paditurën ka lidhur kontratën e rregullt të punës. Në këtë kontekst, gjykata përkujton se nuk ishte kontestues që e paditura, në rastin konkret gabimisht ka konstatuar gjendjen faktike, ashtu që rrëth tetë muaj më vonë, kontratën e rregullt të punës të aktorit Sh. K., e ka shkëputur, duke vazhduar që atë ta angazhoj në teatër sërisht me kontratë për vepër*”.
20. Më 12 maj 2015, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar se Aktgjykimi [C. nr. 2906/12] i Gjykatës Themelore ishte përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave ligjore, zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetim jo të plotë apo të gabuar të gjendjes faktike.
21. Më 15 nëntor 2019, Gjykata e Apelit nëpërmjet Aktgjykimit [Ac.nr. 3544/15], e refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktgjykimin [C. nr. 2996/12] e Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit, lidhur me pretendimet për diskriminim, theksoi se “*Pretendimi për diskriminim në vendin e punës është po ashtu i pathemeltë sepse gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyë të qarta se paditësi nuk është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të pafavorshme, krahasuar me kolegët tjerë në TKK, të cilët kanë qenë në situatë të njëjtë me paditësin*”.
22. Më 28 tetor 2022, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme, me pretendimin se Aktgjykimi [Ac.nr. 3544/15] i Gjykatës së Apelit ishte marrë në zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe shkeljeve tjera.
23. Parashtruesi i kërkesës nëpërmjet kërkesës për revizion theksoi se “*duke marrë parasysh se çështja e legalizimit të vendit të punës të paditësit është realizuar më 12.05.2015, me ç'rast paditësi ka kaluar nga kontrata mbi vepër në kontratë me afat të caktuar, kjo çështje nuk ngelet më kontestuese mes palëve. Kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse ngelet çështja e kompensimit të dëmit në pagë, për shkak të diskriminimit në pagë të paditësit prej datës 01.07.2011, deri më 30.04.2015, që në total si periudhë diskriminuese, i bie 3 vite e 9 muaj*”.
24. Parashtruesi i kërkesës, po ashtu pretendoi se Gjykata e Apelit, “... ashtu sikurse Gjykata Themelore, ka dështuar ta vërtetoj diskriminimin në pagë të paditësit në raport me aktorin Sh. K., për shkak se kjo çështje nga paditësi është referuar në kontest të diskriminimit në pagë përkatësisht në lartësi të koeficientit, kurse Gjykata e ka trajtuar dhe përmendur në kontest tjetër, në atë të kontratës së punës. Kurse paditësi në ankesën e ushtruar në Gjykatën e Apelit, duke goditur Aktgjykimin e Gjykatës Themelore thekson: “*Gjykata ka dështuar të vërtetoj se çështja e aktorit Sh. K., është referuar nga paditësi në kontest të koeficientit, ndërsa gjykata e ka përmendur në kontest tjetër, në atë të kontratës së punës*”. Sa i takon pretendimeve të cekura në paragrafin e mësipërm se paditësi nuk ka arritur të vërtetoj

*diskriminimin në vendin e punës, nuk qëndrojnë sepse paditësi ka qenë i saktë dhe preciz në pretendimin e tij për diskriminim, duke arritur të dëshmoj para gjykatës nëpërmjet provave konkrete këtë diskriminim përfshirë: kontratat e tij të punës, kontratat e aktorit Sh. K. dhe listat e pagave, ku lehtësisht mund të vërtetohet diskriminimi i tij në pagë në periudhën kohore 01.07.2011 deri më 30.04.2015 në raport me të gjithë aktorët tjera, përfshirë rastin e njëjtë Sh. K., e ku diferenca në pagë në mes të paditësit dhe aktorit Sh. K., përfshirë gjithë periudhën diskriminuese të lartpërmendur, në total është 5,020.02 ... euro bruto.*

25. Më 23 nëntor 2022, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin [451/2022], nëpërmjet të cilit refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës. Gjykata Supreme në lidhje me pretendimin për diskriminim, arsyetoi: “*të pabazuara janë pretendimet e theksuara në revizion që kanë të bëjnë me diskriminimin, ngase gjykata e shkallës së parë në mënyrë të qartë dhe precize ka arsyetuar se paditësi nuk është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të pafavorshme në raport me kolegët tjera aktorë që kanë qenë në situatë të njëjtë si paditësi në TKK. Gjykata Supreme i ka vlerësuar pretendimet e përsëritura në revizion, se parashtruesi i revizionit ka qenë i diskriminuar në veçanti në raport me aktorin Sh. K., mirëpo duke marrë parasysh dispozitat e nenit 3 pika a) dhe b) të Ligjit nr. 2004/3 kundër Diskriminimit, si dhe vendimet e gjykatave të instancës më të ulët, Gjykata Supreme nuk ka konstatuar se parashtruesi i revizionit është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të disfavorshme në raport me kolegun e përmendur këtu*”.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të neneve 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNj-së.

#### **i. Pretendimet përkitazi me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës**

*Përkitazi me të drejtën për “vendim të arsyetuar”*

27. Për sa i përket këtij pretendimi parashtruesi i kërkesës, thekson: “*Refuzimin e revizionit Gjykata Supreme e bën nëpërmjet një arsyetimi krejtësisht të paqëndrueshëm dhe jashtë kontestit të pretendimeve të paraqitura në revizion nga paditësi. Paditësi në revizion e informon Gjykatën Supreme se ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk është më kontestuese çështja e legalizimit të vendit të punës së paditësit për shkak se këtë çështje e paditura e kishte zgjidhur në vitin 2015, por kontestuese mbetet çështja e dëmtimit në pagë si rezultat i diskriminimit dhe kompensimi i këtij dëmtimi. Çuditërisht në arsyetim thuhet se paditësi ka kërkuar, kalimin nga kontrata me afat të caktuar në kontratë me afat të pacaktuar, gjë që paditësi nuk e ka kërkuar dhe përmendur asnjëherë në asnjë instancë dhe që s'ka të bëjë fare me këtë kontest, e ku si rrjedhojë kjo Gjykatë i referohet gabimisht edhe Rregullores nr. 05/2011, e cila sipas saj, nuk e zgjidh çështjen e llojit të kontratës*”.
28. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme nuk e adresoi çështjen e diskriminimit, duke theksuar: “... sa i takon kontestit të diskriminimit në pagë dhe diferençës në lartësi të pagës së paditësit dhe aktorit Sh. K., kjo instancë nuk merret fare.

*Përkitazi me “zbatimin e ligjit të gabuar material”*

29. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës thekson: “*Gjykata në aktgjykim thekson se paditësi marrëdhënien e punës mund ta themelojë vetëm bazuar në nenin 8 të Ligjit të punës, por Gjykata nuk e merrte për bazë se paditësi kishte krijuar marrëdhënie pune me të paditurën një vit e gjysmë para se ky ligj të hipte në fuqi.*

*Përkitazi me “paanshmërinë e gjykatës”*

30. Sipas parashtruesit të kërkesës: “*Kjo e drejtë është shkelur me rastin e procedurës gjyqësore për shkak se vet gjykata me rastin e nxjerrjes së aktgjykimeve është e anshme, përfshire Gjykatën Themelore, sipas të cilës nen 8.2 i Ligjit të Punës vlen për paditësin por nuk vlen për kolegët e tij edhe pse paditësi kishte plotësuar në proces kriterin e përcaktuar në rregullore, bazuar në të cilin iu ishin legalizuar vendet e punës kolegëve të tij.*

***ii. Pretendimet përkitazi me shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 14 të KEDNj-së***

31. Për sa i përket këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës thekson: “... ky nen është shkelur... për shkak se ai nuk është trajtuar njëjtë me kolegët së pari në pagë, duke u diskriminuar me një diferencë të konsiderueshme dhe për një periudhë të gjatë kohore, përfshire rastin me kualifikim, pozitë dhe status të njëjtë të përshkruar në rezymer; në kontratë të punës, për shkak se edhe pas përbushjes së kriterit të përcaktuar në rregullore, për dy vite e dhjetë muaj shtesë paditësit nuk i mundësohet legalizimi i vendit të punës sikur kolegëve të tij. Në kohën e hyrjes në fuqi të rregullores, paditësi i kishte dy vjet marrëdhënie pune pa shkëputje kontratë mbi vepër dhe nuk e plotëson kriterin prej tre vjetësh kontratë mbi vepër pa shkëputje të përcaktuar në nënparagrafin 2.2 të nenit 19 të rregullores në fjalë. Por MKRS rastit të njëjtë me paditësin (i cili poashtu i kishte dy vjet marrëdhënie pune pa shkëputje kontratë mbi vepër), Sh.K., ia legalizon vendin e punës, përkatësisht duke ia lidhur kontratën me afat të caktuar. Shtatë muaj pas lidhjes së kontratës së rregullt të punës, MKRS e revokon kontratën e rregullt për Sh. K., me ç'rast edhe ky aktor kalon në kontratë mbi vepër. Por Sh.K. paguhet njëjtë sikurse të gjithë aktorët tjerë që kishin kaluar nga kontrata mbi vepër në kontratë me afat të caktuar në shumën prej 350,000 euro bruto, kurse paditësi vazhdon të paguhet me pagë prej 163,000 euro bruto. Diferenca e lartësisë në nivelin e pagës e aktorit Naim Berisha dhe rastit të njëjtë me pozitë të punës dhe me përgatitje akademike, Sh.K. (i cili është paguar njëjtë si të gjithë kolegët tjerë aktorë) ka zgjatur prej datës 01.07.2011 deri më datë 05.04.2011 dhe përbën një diferencë (përkatësisht dëmtim) prej 5,020,02 euro”.

***iii. Pretendimet përkitazi me shkeljen e nenit 22 të Kushtetutës***

32. Parashtruesi i kërkesës thekson: “*Ky nen është shkelur duke mos u zbatuar dhe marrë parasysh nga e paditura dhe Gjykata zbatimi i KEDNj-së, përkatësisht kapitullit 14*”.

***iv. Pretendimet përkitazi me shkeljen e nenit 23 të Kushtetutës***

33. Parashtruesi i kërkesës pretendon: “*Diskriminimi në pagë nga të gjithë kolegët i paditësit me pozitë të punës aktor dhe me titull akademik MA i Aktrimit në Teatër, si dhe degradimi, zhvlerësimi dhe poshtërimi i tij, duke ia barazuar në nivel identik pagën me dy pastruesit të cilët punojnë në të njëjtin institucion, të cilët kanë pozitë me përgjegjësi shumë më të vogël dhe kanë të përfunduar shkollën fillore, përbën shkelje flagrante të këtij nenit, për shkak se paditësi është zhvlerësuar dhe është bërë të ndjehet me vlerë shumë më të ulët nga ajo që e ka realisht.*

***v. Pretendimet përkitazi me shkeljen e nenit 49 të Kushtetutës***

34. Sa i përket të drejtës së punës dhe ushtrimit të profesionit, parashtruesi i kërkesës thekson: "Duke e marrë parasysh se e drejta e punës përfshin edhe të drejtën e kompensimit për punën e kryer, madje duke marrë parasysh parimin ligjor se në institucionet publike të Republikës së Kosovës për punën me vlerë të njëjtë pagesa duhet të jetë e njëjtë, në këtë rast duke marrë parasysh se paditësi është diskriminuar në mënyrë evidente në pagën bazë, edhe ky nen i Kushtetutës është shkelur, përkatësisht paditësit i është mohuar edhe kjo e drejtë e garantuar me aktin më të lartë juridik të vendit. Gjykata e ka privuar të njëjtin nga e drejta për pushim vjetor dhe atë mjekësor, ashtu siç e kanë shfrytëzuar kolegët e tij".

### **Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore**

#### **KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

##### **Neni 22**

##### **[Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]**

"Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

[...]

2) Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj"

[...]

##### **Neni 23**

##### **[Dinjiteti i Njeriut]**

"Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut".

##### **Neni 24**

##### **[Barazia para Ligjit]**

"1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjeter personal.

3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tillë do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato".

##### **Neni 31**

##### **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj".

### **Neni 49**

#### **[E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]**

- “1. E drejta e punës garantonet.
2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës”.

## **KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

### **Neni 14**

#### **(Ndalimi i diskriminimit)**

“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkage të tillë si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjeter, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjeter”.

## **LIGJI NR.2004/3 KUNDËR DISKRIMINIMIT**

### **Neni 2**

#### **Parimet**

Rregullimi i çështjeve që kanë të bëjnë me mosdiskriminimin mbështetet në këto parime:

- a) Parimin e trajtimit të barabartë që nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj personit, në bazë të gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, paaftësisë fizike apo mendore, orientimit seksual, kombit, mendimit apo bindjes politike, religjionit apo besimit, përkatësisë etnike apo sociale, racës, pronës, lindjes ose statuseve tjera;

[...]

### **Neni 3**

#### **Termet**

Për qëllimet e nenit 2.a, termet në vijim kanë këto kuptime:

- a). Diskriminimi i drejtpërdrejtë nënkuptohet kur një person trajtohet, është trajtuar, ose do të trajtohet në mënyrë të pabarabartë në krahasim me tjetrin, duke u bazuar në një apo më shumë nga bazat e përshkruara nën 2 a;
- b). Diskriminimi i tërthortë nënkuptohet kur nga bazat e përshkruara nën 2 a, një dispozitë, kriter apo praktikë e paanshme në shikim të parë e vënë personin në pozitë të pabarabartë krahasuar me të tjerë, duke u bazuar në një apo më shumë nga bazat që e ndalojnë diskriminimin, përvëç në rastet kur dispozita e tillë, praktika apo kriteri mund të arsyetohet në pikëpamje objektive me një qëllim legjitim dhe me mjete legjitime, të domosdoshme për arritjen e qëllimit;

[...]

**Rregullore nr. 05/2011 për gradimin dhe pagat e krijuesve dhe performuesve të kulturës dhe punonjësve profesionalë të trashëgimisë kulturore**

### **Neni 19**

#### **Procedura e legalizimit**

1. Vendet e punës në institucionet e kulturës dhe të trashëgimisë kulturore legalizohen me automatizëm.
2. Kriteret për legalizim janë:
  - 2.1 Kërkesa për legalizimin e vendeve të punës, e parashtruar nga secili institucion veç e veç.
  - 2.2 Dëshmia për marrëdhënien e punës me kontratë mbi vepër pa shkëputje në tre vjetët e fundit.

[...]

## LIGJI Nr. 03/L-147 PËR PAGAT E NËPUNËSVE CIVILË

### Neni 3 Mbrojtja e të drejtave për pagë

[...]

2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë.

[...]

#### Pranueshmëria e kërkesës

35. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
36. Në këtë drejtim, Gjykata së pari u referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:
  - (1) *Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

[...]
  - (7) *Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

[...]
37. Tuttje, Gjykata u referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, që parashohin:

### Neni 47 (Kërkesa individuale)

1. “Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. *Individ mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

### Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojoë”.

### Neni 49 (Afatet)

“Kërkesa parashtronhet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.[...].”

38. Në vlerësimin e përbushjes së kritereve të pranueshmërisë siç janë cekur më lart, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka specifikuar se konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev. nr. 451/2022] të Gjykatës Supreme të 23 nëntorit 2022, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
39. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Gjykata rikujton se nënrregulli (2) i rregullit 34 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave, Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Për më tepër, nënrregulli (2), përcakton:
- “2. Gjykata mund ta konsiderojet kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/a nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.*
40. Gjykata rikujton që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së si dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsy që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme në bazë të dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjtë vlerëson se përbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në nënrregullin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës (shih rastin [KI04/21](#), parashtruese *Nexhmiye Makollı*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 majit 2021, parografi 26; shih gjithashtu rastin [KI175/20](#), parashtruese *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 prillit 2021, parografi 37).
41. Gjykata gjithashtu konsideron se kërkesa nuk mund të konsiderohet qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç parashihet me paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës, dhe për pasojë, kërkesa shpallet e pranueshme për shqyrtim në merita (shih, gjithashtu rastin e GjEDNj-së, [Alimuçaj kundër Shqipërisë](#), nr. 20134/05, Aktgjykim i 9 korrikut 2012, parografi 144, si dhe shih rastet e Gjykatës [KI75/21](#), parashtrues “*Abrazen LLC*”, “*EnergyDevelopmentGroup Kosova LLC*”, “*Alsi&Co. Kosovë LLC*” dhe “*BuildingConstruction LLC*”, Aktgjykim i 19 janarit 2022, parografi 64; [KI27/20](#), parashtrues, *Lëvizja VETËVENDOSJE!*, Aktgjykim i 22 korrikut 2020, parografi 43, dhe së fundmi [KI82/22](#), parashtrues *Valon Loxhaj*, Aktgjykimi i 7 qershorit 2023, parografi 59).

## **Meritat e kërkesës**

42. Fillimi, Gjykata rikujton se sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNj), një ankesë karakterizohet nga faktet e përfshira në të, dhe jo vetëm nga baza ligjore dhe argumentet në të cilat palët thirren shprehimi (shih, në këtë kuptim rastin e GjEDNj-së: [Talpis kundër Italisë](#), nr. 41237/14, Aktgjykimi i 18 shtatorit 2017, parografi 77 dhe referencat e cituara aty).
43. Gjykata thekson se rrëthanat e rastit konkret, që nga fillimi i procedurave, ndërlidheshin me dy çështje: (i) me legalizimin e vendit të punës, gjegjësisht me kalimin nga kontrata mbi vepër, në kontratë të rregullt të punës, bazuar në ndryshimet e mëvonshme të legjislacionit, dhe (ii) me kompensimin e dëmit material, të shkaktuar si pasojë e diskriminimit në koeficient dhe pagë. Këto kërkesa u refuzuan fillimi, nga MKRS. Kundër kësaj të fundit, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar padi në

Gjykatën Themelore, duke i ngritur si kontestuese këto dy çështje. Gjykata Themelore përkitazi me të parën, e kishte refuzuar padinë, me arsyetimin se nuk ishte plotësuar kriteri ligjor për ndryshim të kontratës. Ndërsa sa i përket të dytës, kishte konstatuar se nuk ka diskriminim në vendin e punës, në raport me kolegët tjerë aktorë të TKK-së. I pakënaqur me këtë konstatim, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila i kishte dhënë të drejtë gjetjeve të Gjykatës Themelore, duke vërtetuar kështu aktgjykimin e saj. Më 12 maj 2015, e paditura MKRS, kishte miratuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës pér kalimin e kontratës nga kontrata mbi vepër në kontratë të rregullt të punës. Parashtruesi i kërkesës, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, kishte ushtruar kërkesë pér revizion në Gjykatën Supreme, dhe kjo e fundit e kishte trajtuar kërkesën e tij në dy aspekte, e para sa i përket kërkesës pér legalizimin të vendit të punës, dhe e dyta pér sa i përket diskriminimit në vendin e punës, në raport me kolegët e tij aktorë, ashtu siç kishin konstatuar gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dyte.

44. Duke mos u pajtuar me konstatimin e Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës me 21 qershor 2023 ka dorëzuar kërkesën në Gjykatë, me pretendimet se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme shkeli të drejtat e tij të garantuara me nenet 22, 23, 24, 31 dhe 49 të Kushtetutës dhe të drejtat e garantuara me nenin 6 dhe 14 të KEDNj-së.
45. Referuar shkresave të lëndës, Gjykata vëren se esenca e pretendimeve që ngërthen kërkesa e parashtruesit të kërkesës, ka të bëj me pretendimin pér shkelje të së drejtës në “gjykim të drejtë” pér shkak se Gjykata Supreme nuk e ka arsyuar në mënyrën e duhur aktgjykimin e saj në lidhje me pretendimin pér diskriminim në pagë.
46. Nisur nga natyra dhe problematikat që i ngrit ky rast, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës duhet të vlerësohen në kuadër të së drejtës pér një vendim të arsyetuar, siç garantohet me paragrafin 1 të nenit 31 [E Drejta pér Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta pér një proces të rregullt) të KEDNj-së. Gjykata po ashtu konsideron se në rrethanat e rastit konkret zbatimi i drejtë i aspektit procedural që ka të bëj me të drejtën pér një vendim të arsyetuar mund ta afektojë aspektin material të kësaj kërkese ashtu që të ketë epilog ndryshe në dobi të parashtruesit të kërkesës.
47. Gjatë vlerësimit të meritave të rastit nën shqyrtim, Gjykata do të zbatojë standarde e praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, në përbushje të kërkesave të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave pér të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, në bazë të të cilit Gjykata dhe jo vetëm, është e detyruar që të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë t'i interpretojë në harmoni me vendimet gjyqësore të GjEDNj-së.

## **I. Vlerësimi i Gjykatës, përkitazi me pretendimin pér shkelje të së drejtës pér një “vendim të arsyetuar”, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës**

- a) *Parimet e përgjithshme*
48. Garancitë e mishëruara në nenin 6, paragrafin 1 të KEDNJ-së, përfshijnë edhe detyrimin e gjykatave që të paraqesin arsyetim të mjaftueshëm pér vendimet e tyre (shih rastin e GJEDNJ-së, [H. kundër Belgjikës](#), nr. 8950/80, Aktgjykim i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53). Vendimi i arsyetuar gjyqësor u tregon palëve se rasti i tyre është shqyrtuar me të vërtetë.
49. Përkundër faktit që gjykata e brendshme ka një liri të caktuar të vlerësimit lidhur me përzgjedhjen e argumenteve dhe vendosjes pér pranueshmërinë e dëshmive, ajo është e detyruar të justifikojë veprimet e saj duke arsyetuar të gjitha vendimet e saj (shih, rastet e GJEDNJ-së: [Suominen kundër Finlandës](#), nr. 37801/97, aktgjykim i 24

korrikut 2003, paragrafi 36; si dhe rastin *Carmel Saliba kundër Maltës*, nr. 24221/13, aktgjykim i 24 prillit 2017, paragrafi 73).

50. Gjykata më e ulët ose autoriteti shtetëror, nga ana tjetër, duhet të jepin arsyetim dhe arsyetime të tillë të cilat do t'u mundësojnë palëve të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës (shih rastin e GJEDNJ-së *Hirvisaari kundër Finlandës*, nr. 49684/99, i 25 dhjetorit 2001, paragrafi 30).
51. Neni 6, paragrafi 1 i detyron gjykatat të jepin arsyetim përvendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument (shih rastet e GJEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës*, nr. 16034/90, aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61; *García Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, aktgjykim i 29 janarit 1999, paragrafi 26; *Perez kundër Francës*, nr. 47287/99, aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81).
52. Nga natyra e vendimit që merr gjykata varet nëse Gjykata është e detyruar ta arsyetojë atë, dhe kjo mund të vendoset vetëm në dritën e rrethanave të rastit në fjalë: është e nevojshme të merren parasysh, ndër të tjera, llojet e ndryshme të parashtresave që një palë mund t'i paraqesë gjykatës, si dhe dallimet që ekzistojnë midis sistemeve juridike të vendeve në lidhje me dispozitat ligjore, rregullat zakonore, pozicionet juridike dhe paraqitjen dhe hartimin e aktgjykimeve (shih rastet e GJEDNJ-së *KI202/21*, nr. 18390/91, aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, nr. 18064/91, aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27).
53. Megjithatë, nëse parashtesa e një pale është vendimtare përvizat e procedurës, ajo kërkon që t'i përgjigjet në mënyrë specifike dhe pa vonesë (shih rastet e GJEDNJ-së, *Ruiz Toria kundër Spanjës*, të cituar më lart, paragrafi 30; *Hiro Balani kundër Spanjës*, të cituar më lart, paragrafi 28).
54. Prandaj, gjykatat janë të obliguara që:
  - (a) të shqyrtojnë argumentet kryesore të palëve (shih rastet e GJEDNJ-së, *Buzescu kundër Rumanisë*, nr. 61302/00, Aktgjykim i 24 gushtit 2005, paragrafi 67; *Donadze kundër Gruzinës*, nr. 74644/01, Aktgjykim i 7 qershorit 2006, paragrafi 35); dhe
  - (b) të shqyrtohen me shumë rigorozitet dhe kujdes të veçantë kërkesat në lidhje me të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, KEDNJ dhe Protokollet e saj (shih rastet e GJEDNJ-së: *Fabris kundër Francës*, 16574/08, aktgjykim i 7 shkurtit 2013, paragrafi 72; *Wagner i JMWL kundër Luksemburgut*, nr. 76240/01, Aktgjykim i 28 qershorit 2007, paragrafi 96).
55. Neni 6, paragrafi 1, nuk kërkon që Gjykata Supreme të jepë një arsyetim më të detajuar kur ajo thjesht zbaton një dispozitë të caktuar ligjore lidhur me bazën ligjore përvizimin e ankesës sepse ajo ankesë nuk ka një perspektivë përvizimin e sukses (shih rastet e GJEDNJ-së, *Burg dhe të tjerët kundër Francës*, nr. 34763/02; vendim i 28 janarit 2003; *Gorou kundër Greqisë (nr. 2)*, nr. 12686/03, vendim i 20 marsit 2009, paragrafi 41).
56. Në mënyrë të ngjashme, në një rast ku bëhet fjalë përvizim kërkues që të lejohet parashtrimi i ankesës, që është një parakusht përvizim te një gjykatë më e lartë, si dhe përvizim të mundshëm, neni 6, paragrafi 1, nuk mund të interpretohet në atë kuptim që të urdhëron një arsyetim të detajuar të vendimit përvizimin e kërkuesës përvizimin e ankesës (shih rastet e GJEDNJ-së, *Kukkonen kundër Finlandës*

(nr. 2), nr. 47628/06, aktgjykim i 13 prillit 2009, paragrafi 24; *Bufferne kundér Francës*, nr. 54367/00, vendimi i 26 shkurtit 2002).

57. Përveç kësaj, kur refuzon një ankesë, Gjykata e Apelit, në parim, thjesht mund të pranojë arsyetimin e vendimit të dhënë nga gjykata më e ulët (shih rastin e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundér Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 26; shih, në kundërshtim me këtë, *Tatishvili kundér Rusisë*, nr. 1509/02, aktgjykim i 9 korrikut 2007, paragrafi 62). Megjithatë, koncepti i procedurës së drejtë nénkupton që gjykata vendase që ka dhënë një shpjegim të ngushtë për vendimet e saj, qoftë duke përsëritur arsyetimet e dhëna më parë nga një gjykatë më e ulët ose në ndonjë mënyrë tjetër, në fakt merrej me çështje të rëndësishme brenda juridiksionit të saj, që do të thotë se nuk i pranoi thjesht dhe pa përpjekje shtesë konkluzionet e arritura nga gjykata më e ulët (shih rastin e GJEDNJ-së, *Helle kundér Finlandës*, nr. (157/1996/776/977), aktgjykim i 19 dhjetorit 1997, paragrafi 60). Kjo kërkesë është aq më e rëndësishme nëse pala në kontest nuk ka pasur mundësi t'i paraqesë argumentet e saj gojarisht në procedurën para gjykatës vendase.
58. Megjithatë, gjykatat e apelit (në shkallën e dytë) të cilat kanë juridiksim për të hedhur poshtë ankesat e pabazuara dhe për të zgjidhur çështjet faktike dhe juridike në procedurën kontestimore, janë të obliguara të arsyetojnë se përsë refuzuan të vendosin për ankesën (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Hansen kundér Norvegjisë*, nr. 15319/09, aktgjykim i 2 janarit 2015, paragrafët 77–83).
59. Përveç kësaj, GJEDNJ nuk përcaktoi se ishte shkelur e drejta në një rast në të cilin nuk është dhënë një sqarim specifik në lidhje me një pohim që i referohej një aspekti të parëndësishëm të rastit, përkatësisht mungesës së nënshkrimit dhe vulës, që është një gabim i një natyre më shumë formale sesa materiale dhe ai gabim u korrigua menjëherë (shih rastin e GJEDNJ-së, *Mugoša kundér Malit të Zi*, nr. 76522/12, aktgjykim i 21 shtatorit 2016, paragrafi 63).

b) *Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrëthanat e rastit konkret*

60. Gjykata sjellë në vëmendje pretendimin e parashtruesit të kërkesës i cili thekson se Aktgjyktimi i Gjykatës Supreme nuk përbën një arsyetim të qëndrueshëm, meqë kjo e fundit ishte informuar se “*nuk është më kontestuese çështja e legalizimit të vendit të punës së paditësit për shkak se këtë çështje e paditura e kishte zgjidhur në vitin 2015, por kontestuese mbetet çështja e dëmtimit në pagë si rezultat i diskriminimit dhe kompensimi i këtij dëmtimi. Quditërisht në arsyetim thuhet se paditësi ka kërkuar kalimin nga kontrata me afat të caktuar në kontratë me afat të pacaktuar, gjë që paditësi nuk e ka kërkuar dhe përmendur asnjëherë në asnje instance dhe që s'ka të bëjë fare me këtë kontest*”. Me këtë rast, parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Supreme e ka injoruar çështjen e diskriminimit në pagë dhe nuk është marrë fare me të.
61. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet Aktgjykit të kontestuar të Gjykatës Supreme dhe vëren se lidhur me pretendimin për diskriminim, kjo e fundit kishte arsyetuar, si në vijim: “*Sipas dispozitave të nenit 19, paragrafi 2 të kësaj Rregullore të përmendur, në të cilin paditësi thirret janë paraparë procedurat dhe kriteret e legalizimit, nënparagrafi 2 përcakton, citohet: "Dëshmia për marrëdhënien e punës me kontratë mbi vepër pa shkëputje në tre vjetët e fundit. Bazuar në të gjitha shkresat e lëndës, dhe në vet deklaratën e paditësit, paditësi në kohën e nxjerrjes së kësaj Rregullore ka qenë në marrëdhënie të pandërprerë të punës me të paditurën, për dy vjet, që do të thotë se nuk e përbushur kriterin e kërkuar dhe se nga ky aspekt, i njëjtë nuk ka qenë i diskriminuar nga e paditura.*”

62. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata Supreme, tutje arsyetoit se, “*Të pabazuara janë pretendimet e theksuara në revizion që kanë të bëjnë me diskriminimin, ngase gjykata e shkallës së parë në mënyrë të qartë dhe prezantuese ka arsyetuar se paditësi nuk është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të pafavorshme në raport me kolegët tjerë aktorë që kanë qenë në situatë të njejtë si paditësi në Teatrin Kombëtar të Kosovës. Gjykata Supreme i ka vlerësuar pretendimet e përsëritura në revizion, se parashtruesi i revizionit ka qenë i diskriminuar në veçanti në raport me aktorin Sh. K., mirëpo duke marrë parasysh dispozitat e nenit 3 pika a) dhe b) të Ligjit nr. 2004/3 kundër Diskriminimit, si dhe vendimet e gjykatave të instancës më të ulët, Gjykata Supreme nuk ka konstatuar se parashtruesi i revizionit është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të disfavorshme në raport me kolegun e përmendur këtu*”.
63. Në anën tjetër, bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, nëpërmjet kërkesës për revizion theksoi: “*duke marrë parasysh se çështja e legalizimit të vendit të punës të paditësit është realizuar më 12.05.2015, me ç'rast paditësi ka kaluar nga kontrata mbi vepër në kontratë me afat të caktuar, kjo çështje nuk ngelet më kontestuese mes palëve. Kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse ngelet çështja e kompensimit të dëmit në pagë, për shkak të diskriminimit në pagë të paditësit prej datës 01.07.2011, deri me 30.04.2015, që në total si periudhë diskriminuese, i bie 3 vite e 9 muaj*”.
64. Sa më lart, Gjykata vëren se përfundimet e Gjykatës Supreme janë të ndërlidhura me konkluzionet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, të cilat trajtuan vetëm çështjen e diskriminimit mes parashtruesit të kërkesës dhe kolegëve të tij aktorë për mos-legalizimin e vendit të punës, gjegjësisht për mos-shndërrimin e kontratës mbi vepër, në kontratë të rregullt, çështje e cila ishte rregulluar përfundimisht në vitin 2015 nga vetë e paditura MKRS. Në lidhje me këtë fakt, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kishte njofuar Gjykatën e Apelit dhe kishte kërkuar të trajtohet veçmas diskriminimi në pagë, e cila kishte mbetur si çështje kontestuese mes palëve. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës duke mos marr përgjigje nga Gjykata e Apelit, i njëjti nëpërmjet kërkesës për revizion shprehimisht kishte theksuar: “*Gjykata (Apeli) në AKTGJYKIM, dështon ta vërtetoj diskriminimin në pagë të paditësit, në raport me rastin e njejtë Shpejtim Kastrati, edhe pse paditësi ia ka ofruar si dëshmi Gjykatës kontratat e tij, dy kontrata të Sh.K dhe listën e pagave, ku qartësisht konstatohet diskriminimi. Përkundrazi, edhe pse paditësi çështjes së aktorit Sh. K., i është referuar në kontest të pagës, Gjykata ka devijuar duke e përmendur në kontest tjetër, në atë të kontratës së punës*”.
65. Gjykata vëren se pranë Gjykatës Supreme parashtruesi i kërkesës në mënyrë specifike kishte kërkuar të trajtohej pretendimi përkitazi me diskriminimin në pagë, për periudhën 1 korrik 2011 - 30 prill 2015, duke argumentuar se përgjatë kësaj periudhe ai është paguar sikurse janë paguar edhe dy (2) punëtorët (pastruesit) e TKK-së, dhe jo sa kolegët tjerë aktorë të teatrit kombëtar.
66. Gjykata rikujton se çështja (i) e legalizimit të vendit të punës për parashtruesin e kërkesës ishte kontestuese deri në momentin kur e paditura MKRS, më 12 maj 2015, e kishte miratuar kërkesën për kalimin nga kontrata mbi vepër në kontratë të rregullt të punës. Ky fakt nuk ishte më çështje kontestuese për parashtruesin e kërkesës dhe për të paditurën MKRS. Çështje kontestuese edhe më tej kishte mbetur diskriminimi në pagë, i cili në mënyrë specifike i referohet periudhës 1 korrik 2011 - 30 prill 2015, për të cilën ai kishte dorëzuar pranë gjykatave si dëshmi listat e pagave, në mbështetje të këtij pretendimi specifik. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës, përvèç dispozitave kundër diskriminimit, iu referua edhe paragrafit 2 të nenit 3 (Mbrojtja e të drejtave për pagë) të Ligjit 03/L-147 për pagat e nëpunësve civilë, si ligj në fuqi atë periudhë, që

përcaktonte: “*2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë*”.

67. Andaj, Gjykata vlerëson se thelbi i pretendimit të parashtruesit të kérkesës që kérkonte përgjigje specifike nga ana e Gjykatës Supreme nuk ishte më çështja (i) e legalizimit të vendit të punës, gjegjësisht e kalimit nga kontrata mbi vepër në kontratë të rregullt, e cila ishte trajtuar nga gjykata e shkallës së parë dhe e shkallës së dytë, por (ii) çështja e diskriminimit në pagë, për periudhën e lartcekur kohore. Në këtë kontest, Gjykata Supreme është dashur të trajtojë pretendimin e parashtruesit të kérkesës me saktësi ashtu siç parashtruesi i kérkesës specifikisht e kishte ngritur në kérkesën e tij për revizion, duke i dhënë kështu përgjigje pretendimeve për diskriminim në pagë dhe jo të trajtonte çështjen e diskriminimit në kontekst të legalizimit të vendit të punës mes tij dhe kolegëve të tij, sepse kjo çështje nuk ishte më kontestuese, nga viti 2015, me vetë faktin se kontrata e tij e punës edhe në kuptim të koeficientit të pagës tashmë ishte barazuar me kolegët e tij aktorë.
68. Gjykata vlerëson se pretendimi i parashtruesit të kérkesës ishte thelbësor dhe vendimtar për të zgjidhur kontestin mes tij dhe MKRS-së, për periudhën kontestuese 1 korrik 2011 - 30 prill 2015. Për më tepër pretendimi i tij ishte specifik, i argumentuar dhe i mbështetur në dëshmi materiale. Adresimi i duhur i këtij pretendimi specifik nga ana e gjykatave të rregullta, sidomos nga Gjykata Supreme do të forconte bindjen tek parashtruesi i kérkesës se ai është dëgjuar në mënyrën e duhur dhe në pajtueshmëri me kérkesat e paragrafit 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në ndërlidhje me paragrin 1 të nenit 6 të KEDNj-së.
69. Sikur, Gjykata Supreme të adresonte pretendimin thelbësor të parashtruesit të kérkesës në kuadër të diskriminimit në pagë, atëherë kushti i palës së dëgjuar dhe i administrimit të duhur të drejtësisë do të ishte përbushur. Vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të ketë shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë. (Shih, *mutatis mutandis*, rastet e GjEDNj-së [Hirvisaari kundër Finlandës](#), kérkesa nr. 49684/99, 27 shtator 2001, parografi 30; [Tatishvili kundër Rusisë](#), kérkesa nr. 1509/02, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007, parografi 58; dhe [Suominen kundër Finlandës](#), kérkesa nr. 37801/97, Aktgjykimi i 1 korrikut 2003, parografi 37).
70. Gjykata vë në pah se nuk është detyrë e Gjykatës të ekzaminojë deri në çfarë mase janë të arsyeshme pretendimet e parashtruesve të kérkesave, në procedurat pranë gjykatave të rregullta. Megjithatë, drejtësia procedurale e kérkon që pretendimeve specifike dhe thelbësore gjykatat duhet dhënë përgjigje konkrete dhe të duhur, posaçërisht kur shqyrtimi i thelbit të tyre mund të sjellë një rezultat të favorshëm për parashtruesin e kérkesës.
71. Thënë këtë dhe pas vlerësimit të procedurave në tërsi, dhe posaçërisht nga leximi i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Gjykata konstaton se mosadresimi dhe mosarsyetimi i pretendimit thelbësor të parashtruesve të kérkesës në rr Ethanat e këtij rasti konkret, përbën një të metë procedurale të pakapërcyeshme e cila nuk është në pajtueshmëri me të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor.
72. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se Aktgjykimi [Rev. nr. 451/2022] i 23 nëntorit 2022 i Gjykatës Supreme nuk është në pajtueshmëri me kérkesat e paragrafit 1, të nenit 31 të Kushtetutës dhe të paragrafit 1, të nenit 6 të KEDNj-së, për arsyet e lartcekura.

#### *Përkitazi me pretendimet tjera*

73. Gjykata sapo ka konstatuar se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, është marrë në shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar dhe të arsyeshëm, andaj nuk e konsideron të

nevojshëm të trajtojë pretendimet tjera të ngritura në kërkesë të cilat në substancë ndërlidhen në çështjet e diskriminimit në kuptim të neneve 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNj-së, pasi që nga Gjkata Supreme pritet që në procedurën e rigjykimit të trajtojë specifikisht çështjen e diskriminimit, në përputhje me gjetjet e Gjykatës në këtë Aktgjykim.

## Përfundim

74. Gjkata përfundon se në rastin konkret ka konstatuar shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar, si një nga komponentët e të drejtës së përgjithshme për një gjykim të drejtë që garanton drejtësi procedurale të mishëruar në paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së. Gjkata rithekson se e drejta për një vendim të arsyetuar dhe të arsyeshëm kërkon që pretendimeve thelbësore të ngritura nga parashtruesi i kërkesës në gjykatat e rregullta duhet dhënë përgjigje të duhur dhe konkrete, aq më tepër kur probabiliteti për një rezultat të favorshme për parashtruesit e keqësueseve është i pritshëm dhe i mundur.
75. Sa më sipër, Gjkata nëpërmjet këtij Aktgjykimi obligon Gjkatën Supreme që në rigjykin e kësaj çështjeje, në mënyrë të saktë dhe pa dykuptimësi të konstatojnë nëse në rastin e parashtruesit të kërkesës, referuar periudhës kohore 1 korrik 2011 - 30 prill 2015, ekziston diskriminim në pagë, duke e trajtuar këtë çështje në përputhje me parimin e efektshmërisë së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, siç garantohen me paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së.


## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 48 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur, më 18 janar 2024:

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË, me pesë (5) vota për dhe tri (3) kundër, kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, me pesë (5) vota për dhe tri (3) kundër, se ka pasur shkelje të paragrafit 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në ndërlidhje me paragrin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TË SHPALLË, me pesë (5) vota për dhe tri (3) kundër, të pavlefshëm Aktgjykimin [Rev. nr. 451/2022] e 23 nëntorit 2022 të Gjykatës Supreme;
- IV. TË KTHEJË, me pesë (5) vota për dhe tri (3) kundër, çështjen për rishqyrtim në Gjykatën Supreme, në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;
- V. TË URDHËROJË Gjykatën Supreme që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me nënrrregullin (5) të rregullit 66 (Zbatimi i vendimeve) të Rregullores së punës, deri më 18 korrik 2024, për masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjyki të Gjykatës;
- VI. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me paragrin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë në Gazeten Zyrtare të Republikës së Kosovës;
- VII. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazeten Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues



Radomir Laban

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani